



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.08.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.268, datë 07.08.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 13:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ilir Toska** (anëtar)
- 7. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 8. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës: anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Medi Bici**; anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Alban Toro**.

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 26.08.2020 (Pika 1)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.268, datë 07.08.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e datës 26 gusht 2020.

Siç jeni vënë në dijeni, në shqyrtim në këtë mbledhje janë tre çështje. Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e një projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr.268, datë 07.08.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Çështja e dytë ka të bëjë me “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit Markelian Kuqo, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor. Dhe çështja e tretë ka të bëjë me caktimin gjyqtarit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, (në Gjykatën e Apelit Shkodër), i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Atëherë, pa humbur kohë fillojmë me relatimin e çështjes së parë, që do relatohet nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr.268, datë 07.08.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Me këtë vendim, KLGJ ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për

pozicionet e lira të shpallura me vendimet e tij nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020.

Më herët, më datë 03.08.2020, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor është publikuar njoftimi “Mbi kandidaturat e paraqitura në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në të cilin, ndër të tjera, është pasqyruar se (pika 3): III. Për pozicionin në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, lista e kandidatëve është: {...} – {...}.

Ndërkohë, pas publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe të vendimit të tij nr. 268, datë 07.08.2020, z.{...}, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, më datë 13.08.2020, ka depozituar pranë Këshillit, në rrugë elektronike, një njoftim, përmes të cilit bën me dije se ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, por se emri i tij nuk gjendej në listën e kandidatëve për këtë pozicion, duke kërkuar kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe ndreqjen e këtij gabimi.

Mbi këtë njoftim të z. {...}, u kryen verifikime pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga ku rezultoi se ai, më datë 13.07.2020, ka depozituar në këtë zyrë disa dokumente, protokolluar me aktin nr.2295/2 prot., datë 13.07.2020. Në këtë rast, nëpunësi i protokollit ka plotësuar kartelën shoqëruese të praktikës duke evidentuar si lëndë “Dërgim formularësh”.

Kjo praktikë dokumentare i ka kaluar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ndërsa z. {...}, më herët, kishte kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 86, datë 26.02.2020, kandidim për të cilin, me vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, për të kishte filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit. Për këtë shkak, referuar lëndës së pasqyruar në kartelën shoqëruese të praktikës, dokumentacioni i dorëzuar nga z. {...}, po më datë 13.07.2020, i ka kaluar anëtares së Komisionit, znj. Marçela Shehu, e ngarkuar si relatore për verifikimit e kriterëve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Lartë të z. {...}.

Pas njoftimit si më lart nga z. {...}, u këqyr praktika dokumentare e protokolluar me aktin nr.2295/2 prot., datë 13.07.2020, nga ku rezultoi se dokumentacioni i dorëzuar në këtë rast nuk kishte të bënte me procedurën e verifikimit që po realizohej ndaj tij sa i përkiste kandidimit për në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin

nr. 86, datë 26.02.2020, por ai në fakt përmbante një kërkesë “Për shprehje interesi për ngritjen në detyrë”, pikërisht në Gjykatën e Lartë, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sikundëre dhe dy formularë vetëdeklarimi, një për masa disiplinore dhe tjetri për situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Nga sa rezulton nga verifikimi i bërë del se z. {...}, më datë 13.07.2020, pra brenda afatit të kandidimit, ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, fakt i cili gabimisht nuk është patur parasysh në rastin e njoftimit publik të datës 03.08.2020, për publikimin e listës së kandidatëve për këtë pozicion të lirë, sikundër edhe në rastin e marrjes së vendimit nr. 268, datë 07.08.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe me vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në këto kushte është vendi për ndreqjen e kësaj mangësie, shkak për të cilin Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për një shtesë në Vendimin nr.268, datë 07.08.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi përbëhet vetëm nga një pikë, në të cilën përcaktohet se në pikën 4, të vendimit nr. 268, datë 07.08.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas emrit të kandidates znj. Alma Hicka, shtohet emri i kandidatit z. {...}.

Lidhur me këtë vlen të sillet në vëmendje se në pikën 4, të vendimit nr. 268, datë 07.08.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Për kandidatët znj. {...} – {...}, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të posaçëm, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për një ose disa nga pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, me vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, si dhe me vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Pra, nëpërmjet rregullimit të kësaj pike është zgjidhur situata e verifikimit të pasurisë dhe figurës për ata kandidatë që kanë kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë,

kandidime për të cilat procedurat e verifikimit ishin në proces e sipër. Pikërisht në të njëjtën situatë është dhe z. {...}, i cili, siç u përmend, është në proces e sipër verifikimi për shkak të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, sa i përket gabimit në njoftimin e publikuar, më datë 03.08.2020, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se është vendi për nxjerrjen e një njoftimi të ri, përmes të cilit të publikohen listat e përditësuara të kandidatëve (pas rikonsiderimit të kandidimeve nga disa prej tyre) për të njëmbëdhjetë pozicionet e lira të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim paraprak lidhur me projektvendimin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projektvendimit sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.08.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, (në Gjykatën e Apelit Shkodër), i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 13:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)*
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Zoti Bici futet në platformën “online” gjatë trajtimit të kësaj pike të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**

RENDI I DITËS:

2. Caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, (në Gjykatën e Apelit Shkodër), i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Të njoftojmë Albanin që të jetë prezent në vazhdimin e mbledhjes.

(Njoftohet z. Toro për t'u futur në platformën “online”.)

Unë do të sugjeroja që të vazhdonim tek çështja e tretë e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, me qëllim që t'i japim mundësi nëse zoti Bici arrin të futet “online”.

Dakord Ilir?

Alban Toro: Përshëndetje!

Dëgjohem?

Naureda Llagami: Po Alban!

Atëherë, Ilir vazhdojmë?

Ilir Toska: Mirë atëherë, lidhur me çështjen e tretë të rendit të ditës (*sipas rendit*) nga Gjykata e Apelit Shkodër është paraqitur një kërkesë ku ka nevojë për caktimin e një gjyqtari, çështje kjo me karakter “tepër urgjent”, ndërsa ka të bëjë me caktim mase “Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal”.

Në këtë rast është i pazbatueshëm zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit për shkak padisponueshmërie të gjyqtarëve në këtë skemë, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar vendimit nr. 30 të vitit 2019 të KLGJ-së, në bazë të të cilit KZHK propozon që: Gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e saj, të jetë 1, saç është edhe nevoja.

Propozimi vijues është që për 1 çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë në listën e gatishmërisë përgjatë kësaj jave, meqenëse jemi gjatë muajit gusht dhe gjyqtarët janë edhe me pushimet vjetore.

Propozimi tjetër është që të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, nëse është në listën e gatishmërisë përgjatë kësaj jave, konkretisht: z. Desart Avdulaj.

Nga informacioni i marrë nga Gjykata e Apelit Durrës, rezulton që zoti Avdulaj është në listën e gatishmërisë, por që nuk duhet të përfshihet. Sipas informacionit, në listën e gatishmërisë janë: z. Desart Avdulaj, z. Valbon Çekrezi dhe z. Tritan Hamitaj. Pra shorti duhet të hidhet mes këtyre tre gjyqtarëve.

Nëse nuk ka kundërshtime nga anëtarët me propozimet e Komisionit, mund të procedojmë me shortin elektronik.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimet e Komisionit.)

Mirë atëherë, meqenëse nuk ka kundërshtime për propozimet e Komisionit, Valbona të procedojë me hedhjen e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 1 (sipas relacionit) për zgjidhet gjyqtari Valbon Çekrezi.

Illir Toska: Me kaq mbyllet procedura e shortit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.08.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 13:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e tretë, e cila ka të bëjë me caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Për më shumë detaje do të doja që të ftoja zotin Bici për të relatuar çështjen.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 03.08.2020 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, dhe nenit 138 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja ”a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Së bashku me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit {...}, të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 111 i ligjit nr.96/2016 “Për

statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar raporti i hetimit disiplinor si dhe dosja hetimore.

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicion një procedurë individuale administrative në Këshill, e cila ka lidhje me statusin profesional të gjyqtarit {...}, në zbatim të nenit 63 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit. Relator do të caktohet njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Menjëherë pas caktimit me short të relatorit duhet të procedohet me caktimin e mbledhjes plenare të radhës, në të cilën Këshilli, mbi relacionin për gatitur nga relatori, mund të vendosë mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ose caktimin e datës së seancës dëgjimore sipas nenit 138/2 të këtij ligji.

Në zhvillimin e kësaj procedure, nëse do të procedohet me caktimin e seancës dëgjimore, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë afatin maksimal njëmuajor në caktimin e seancës dëgjimore, afat i cili, për shkaqe të rëndësishme, mund të zgjatet deri në dy muaj. Ky afat fillon nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Gjithashtu, ligji parashikon dhe afatin minimal 15-ditor për njoftimin e palëve për datën e seancës dëgjimore.

Për këto shkaqe, Komisioni Disiplinor, duke u bazuar në nenin 63 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenin 138 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i kërkon mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.1/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Përveç relacionit, Komisioni i Disiplinës ka për gatitur edhe projektvendimin, duke u bazuar në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 63 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, nenet 138 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Komisionit Disiplinor, të caktojë

njërën nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës si relatori të kësaj çështjeje. Ky vendim duhet t'i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...}, brenda një afati 5-ditor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitit të subjektit të proceduar. Faleminderit, zonja Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici për relacionin dhe për relatimin e aktit.

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, atëherë fillojmë me hedhjen e procedurës së shortit (me goglat).

Futen në enën e qelqit tre emrat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor: z. Medi Bici, z. Maksim Qoku dhe z. Dritan Hallunaj.

Pas përzgjedhjes së goglës, relator për çështjen e sipërcituar është z. Dritan Hallunaj.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin e anëtarit të Komisionit të Disiplinës z. Dritan Hallunaj në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 1/2020 në ngarkim të magjistratit {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

2. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...}, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Atëherë, me këtë projekt-akt mbyllim mbledhjen e sotshme.

Ju uroj një ditë të mbarë!

Mirupafshim të gjithëve!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor